

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT

SFIDA
10 MILION
turistë

**FESTAT LOKALE
2019**

Smile
from  Albania

TIRANA

KALENDARI I FESTAVE 2019



DAJTI N'FEST

Një fundjavë dedikuar malit. Gara profesioniste me Mountain Bike dhe motoçikleta DJ, festë kampionësh të sporteve outdoor. Qindra të apasionuar të aventurës mbushin me adrenalinë Dajtin! Një sërë aktivitete kulturore me veshje tradicionale të qëndisura me mjeshtëri nga duartët e zonave të ndryshme, muzikë e valle tipike të trojeve të Shqipërisë sonë, si dhe mësimë gatimi me zairetë e mrekullueshme të malit e dimrit zhvillohet Paragliding. Fluturime me balonë dhe hiking në shtigjet e virgjëra të Dajtit ku profesionistë do të shoqërojnë të apasionuarit e ecjes në natyrë me anë të aplikacionit TIO.

TURIZËM



9
SHKURT

DITA E VERËS

Festa e Ditës së Verës, si një festë e përvitshme dhe tashmë traditë në kryeqytet, celebrimet me organizim koncertesh, panairesh, sporte dhe "street party" në disa zona të Tiranës; liqeni, sheshi Skenderbeu, Dajti, zona e ish-Bllokut, etj.

TURIZËM



14
MARS

FARKA AGROTURIZËM FAIR

Bizneset lokale që operojnë në këtë zonë organizojnë një aktivitet i cili përcjellë pranë publikut informacion mbi produktet bujqësore, blektorale, gastronomike etj, që prodhohen në fshatrat përreth.

TURIZËM




22
MARS

VERA NË SHESH

Fshati "Shesh", i cili gjendet 18 km larg qendrës së Tiranës, kthehet në datat 7 dhe 8 shtator, në qendrën e vëmendjes të verëdashësve Shqiptarë. Vera në Shesh është aktiviteti në të cilin ftohen të marrin pjesë të gjithë qytetarët, të cilët duan të shijojnë produktet cilësore agroushqimore të kilometrit zero dhe të gjitha nënproduktet e rrushit "Sheshi i bardh" dhe "Sheshi i zi" prej nga ku merr emër dhe ky fshat. Në mbrëmjen e datës 7 shtator organizohet edhe një minikoncert me këngëtar të Shqipërisë së mesme, të veshur me kostume popullore, duke dashur kështu të promovojmë edhe kulturën vendase.

TURIZËM



7-8
SHTATOR

DOMATE FEST

"Domatja e Shëngjergjit", do të jetë kryefjala në datat 22-23 shtator, në Shëngjergj. Gjatë kësaj mbrëmjeje do të kemi organizimin e një koncerti folk, duke dashur kështu të promovojmë edhe kulturën vendase. S'do të mungojnë as guidat shpjeguese të procesit se si arrijmë nga mbjellja deri në grumbullim tek domatja.

TURIZËM



SHËNGJERGJ

22 E SHTUNË 22 SHTATOR ORA 09.00

22

MARS



Agjencia
për
Zhvillimin
Rural



Smile
from Albania

TAKOHEMI NË PETRELË

Vizitë në Kalanë e Petrelës dhe Vendbanimin antik të Persqopit. Të gjithë e njohim kalanë e Petrelës, të pozicionuar në një nga zonat më strategjike të Tiranës, me fushëpamje të gjerë mbi Erzen. Por pak e dinë që në jug të saj, ndodhet një nga vendbanimet ilire më të rëndësishme në zonën e Tiranës, Vendbanimi i Persqopit, nga i cili ka mbetur një mur i lartë dhe një varr monumental tregues i rëndësisë së zonës.

TURIZËM



29

SHTATOR

PEZA N'FEST

TURIZËM

Peza do të kthehet në një vendtakim për të gjithë ata që do duan të kujtojnë ditën historike të Konferencës së Pezës, por edhe të argëtohen me aktivitete të ndryshme sportive dhe artistike si dhe të shijojnë në të njëjtën kohë bukuritë e natyrës si dhe produktet bujqësore të zonës. Bashkia e Tiranës ka hartuar një kalendar të ngjeshur aktiviteteve për të gjitha moshat, që do të nisë nga ora 09:00. Peza N'Fest rikthehet si destinacion i promovimit të vlerave e traditave të bukura shqiptare dhe të muzikës së mirë.



SHTATOR

HALLOWEEN NË PARK

TURIZËM

Aktivitete për fëmijë. Aktivitete me maska, lojra, koncerte, etj. Hapësira ku do të zhvillohet aktiviteti do të zbukurohet me simbole të Halloween për t'ju dhënë mundësi fëmijëve të shprehin fantazinë.



30
TETOR

NATA E BARDHË

TURIZËM

Nata e Bardhë tashmë është një festë tradite për qytetin e Tiranës. Në kuadër të festimeve të kësaj dite ftohen të marrin pjesë artistë me famë botërore, të cilët performojnë live në një nga sheshet kryesore të Tiranës.



ECJE TE KANIONET E ERZENIT

TURIZËM

Të dielën më 7 korrik është menduar një udhëtim për në fshatin Pëllumbas, në drejtim të kanionit të Erzenit. Një pjesë e ecjes do të bëhet tek një shteg, buzë një kanali vaditës të vjetër, dhe më pas do të vazhdojë ngjitja, buzë kanionit, për të mbërritur tek një pjesë ku lumi ka një thyerje rreth 10 m, duke krijuar një ujëvarë shumë të bukur brenda një guve. E gjithë ecja vajtje dhe kthim do të shkojë rreth 4 orë.



7

KORRIK

KAMËZ

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E MIKËPRITJES

FESTIVAL

Aktivitet në qendrën e
qytetit me koncert muzikor,
krijime dhe degustime.

29
PRILL



VORË

KALENDARI I FESTAVE 2019



ORGANIZIMI I PANAIRIT AGRO - USHQIMOR

TURIZËM

Promovimin e agrobiznesit të zonës dhe zhvillimit ekonomik dhe trashëgimisë kulturore të Vorës. Një ekspozitë e pasurisë së trashëguar etnografike, mjeshtërisë artizanale, kulinarisë dhe agrobiznesit.



27
PRILL

AGROTURIZËM NË PREZË

TURIZËM

Promovimin e agrobiznesit të zonës dhe zhvillimit ekonomik dhe trashëgimisë kulturore të Vorës. Një ekspozitë e pasurisë së trashëguar etnografike, mjeshtërisë artizanale, kulinarisë dhe agrobiznesit.




29
PRILL

FESTA E PRODHIMIT TË VERËS

TURIZËM

Në këtë festë çdo pjesëmarrës është i pajisur me kavaletën, telajon, penelat dhe bojrat dhe pikturon nën drejtimin e mjeshtreve të pikturës shqiptare. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, bëhet ndërkohë dhe degustimi i verërave më të mira të prodhuara në Seferan.

20
DHJETOR



KRUJË

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E PAZARIT "TID DAY"

TURIZËM

"TID DAY" hapja e sezonit turistik, kulinari, folklori krutan dhe artistë. Kjo është një mënyrë për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe social-historike të kësaj zone.



20
PRILL

DITA E LINDJES SË HEROIT KOMBËTAR SKËNDERBEU

TURIZËM

Data 6 Maj është data në të cilën lindi Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Simbolika e kësaj feste në qytetin e Krujës fillon me një përmbledhje historike me tematikën e eventit me pas e shoqëruar me shfaqje, vallëzime dhe muzikë tradicionale shqiptare nga grupi i të rinjve. Veçantia e kësaj dite qëndron në shëtitjen me guidë profesionale në shtigjet dhe në malin e Skënderbeut dhe banket në natyrë me një shumëllojshmëri ushqimesh.



6
MAJ

DITA E MALIT TË KRUJËS

TURIZËM

Panair, folklor dhe artizanat në ditën e malit të Krujës, ku mijera besimtarë, vizitojnë Teqenë e Sari Saltikut.


3

GUSHT



DURRËS

KALENDARI I FESTAVE 2019



AKULLORE SI DIKUR

TURIZËM

“Akullore si dikur” është festa e kulinarisë që ju pret në shëtitoren “Taulantia” për të shijuar produktin tipik të qytetit bregdetar.

11-13

KORRIK

FESTA E VJELJES SË RRUSHIT

TURIZËM

Vjelja e rrushit në vreshtat e kantinës ka të bëjë me transportimin dhe përpunimin në kantinë, degustimin e verës me gatimet lokale të zonës së Ishmit, njohja me produktet tradicionale të zonës, si dhe aktivitete sportive në liqenin e Topanasë.

14

SHTATOR

KORÇË

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E ASHURES

TURIZËM

Festë tradicionale e besimtarëve bektashinj, të cilën fshati Turan e kremton për të disatin vit rradhazi. Krahas riteve tradicionale, gjatë kësaj dite organizohet dhe një panair me produkte vendase bujqësore, si dhe me gatime tradicionale, sidomos "ashuren". Ftohen të gjitha amvisat e zonës për të marrë pjesë në konkursin "Ashurja më e mirë", si dhe demonstrohen recetat e gatimit të ashures.

22
MARS

PANAIRI I POÇERISË

KULTURË

Ky panair promovon vlerat e trashëguara brez pas brezi të poçarisë, si dhe ngjalljen e interesit tek të rinjtë. Gjatë zhvillimit të panairit ekspozohen objekte të ndryshme prej balte nga tregtarë dhe prodhues të qyteteve të ndryshme, duke synuar kështu vendosjen e urave të bashkëpunimit.

5
PRILL

DITA E TOKËS

KULTURË

Dita ndërkombëtare e Tokës, ndryshe konsiderohet si dita e apelit ndaj problemeve që lidhen me ndotjen, keqpërdorimin dhe braktisjen e tokës. Kjo ditë angazhon njerëzit anë e mbanë botës në mbrojtje të Tokës, për t'i shprehur në njëfarë mënyre mirënjohjen tonë.

22
PRILL

PANAIRI I PRANVERËS

TURIZËM

Panair i cili zhvillohet në Korçë në çelje të sezonit pranveror, dhe shoqërohet nga një sërë aktiviteteve të ndryshme artistike dhe kulturore.

PRILL

FESTA E KAMENICËS

TURIZËM

Kjo feste ka në fokus organizmin e një mini panairi me produkte vendase bujqësore, si dhe me gatime tradicionale. Në një kënd të posaçëm demonstrohen recetat e gatimit të zonës. Të ftuarit kanë mundësi të vizitojnë fshatin, bukuritë natyrore si dhe të shijojnë gatimet e zonës.

6
MAJ

KARNAVALET E KORÇËS

TURIZËM

Qyteti i Korçës çel sezonin turistik më 7 qershor, me Festivalin Ndërkombëtar të Karnavaleve. Kjo festë e bukur, bazuar në një nga traditat më të spikatura të qytetit të kulturës, fton vizitorë nga e gjithë Shqipëria, si edhe shumë turistë të huaj të cilët së bashku me qytetarët korçarë shijojnë paradën e grupeve të karnavaleve dhe bëhen pjesë e festimeve.

7-8
QËRSHOR

FESTA E VOSKOPOJËS

TURIZËM

Fshati turistik me kulturë dhe tradita organizon panairin me produkte vendase bujqësorë si dhe me gatime tradicionale. Në një kënd të posaçëm të saj do të ju demonstron recetat e gatimit të zonës të cilat do të shoqërohen me muzikë dhe valle popullore.

24
QERSHOR

FESTA E VITHKUQIT

TURIZËM

Vithkuqi, qyteri mesjetar që shërben si muzë frymëzimi e kulture ju fton të jeni pjesë e tavolinave me ushqimet tradicionale, që kanë shije të veçantë dhe që shkojnë shumë mirë të shoqëruara me pijen karakteristike, rakinë e kumbullës. Të gjitha këto do të shoqërohen me këngën popullore vithkuqare që është ruajtur nga ndikimet e huaja, ose të shohësh djemtë dhe vajzat e Vithkuqit duke kërcyer vallen e Dados.

29
QERSHOR

FESTA E VOSKOPOJËS

TURIZËM

Festa me gatime tradicionale të zonës si dhe produkte bujqësore do të shoqërohet me një koncert me këngë e valle tradicionale të zonës si dhe nuk do të mungojnë aktivitetet për fëmijë. Mjafton të dalësh shëtitje mëngjeseve apo mbrëmjeve, për të thithur ajrin e freskët, për të shijuar ujin e burimeve apo çezmave të shumta nëpër fshat, për të bërë kamping apo ekskursione. Po ashtu nuk mund të largohesh pa shijuar lakrorin në saç, qengjin në hell, rakinë e kumbullës, petullat e fshira, petkat, petanikun, kulaçin, etj.

30
QERSHOR

PANAIR ME PUNIMET ARTIZANALE TË QYTETIT TË KORÇËS

KULTURË

Tradita e banorëve të Korçës në bërjen e punimeve artizanale, duke nisur nga thurja e thuprave deri në traditën agroushqimore do të prezantohet nga nxënësit e shkollave.

QERSHOR

FESTA E LAKRORIT

TURIZËM

Lakrori i famshëm me dy petë, i Korçës është shndërruar në një festë popullore për qytetin dhe jo vetëm. Në muajin korrik, në parkun e qytetit, gra korçare do të hapin petë para syve kureshtarë të vizitorëve që mezi presin të shijojnë lakrorin e sapopjekur në saç. Muzikë, program për fëmijë dhe të tjera surpriza do të jenë pjesë e festës më të veçantë të qytetit.

28
KORRIK

FESTA E BIRRËS

KULTURË

Festa më e madhe në qytet, e cila organizohet që nga viti 2007, ku mbledh mijëra vizitorë vendas dhe të ardhur nga jashtë Shqipërisë, ku për 5 netë mund të shijojnë birrën e ftohtë, produktet tradicionale të Korçës dhe muzikën më të mirë deri në orët e para të mëngjesit.

14-18.
GUSHT

FESTA E RAKISË

KULTURË

Fokusi i kësaj feste është organizmi i një mini panairi me produkte vendase bujqësore, si dhe me gatime tradicionale, me bazë frutin e manave. Të ftuarit do të kenë mundësi të vizitojnë fshatin, bukuritë natyrore, shijojnë gatimet e zonës, si dhe të mbledhin mana në një nga fermat e fshatit.

15
GUSHT

FESTA E DARDHËS

TURIZËM

Fshati piktoresk i Dardhës me elementët arkitekturore të shtëpive dhe çatave me pllota, ju fton në panairin me produkte vendase bujqësore, si dhe me gatime tradicionale, duke i dhënë një fokus të veçantë rakisë së kumbullës, produktit tipik të zonës. Në një kënd të posaçëm, do të demonstrohen recetat e gatimit të zonës, në atmosferën e muzikës popullore nga artistë vendas.

16
GUSHT

FESTA E MELÇANIT

TURIZËM

Kjo festë do të ketë në fokus organizmin e një mini panairi me produkte vendase bujqësore, si dhe me gatime tradicionale, sidomos me bazë frutin e manave. Në një kënd të posaçëm do të ketë një mini kënd guzhine, ku do të demonstrohen recetat e gatimit të zonës. Festa shoqërohet dhe me muzikë popullore të zonës nga artistë vendas. Të ftuarit do të kenë mundësi të vizitojnë fshatin dhe bukuritë natyrore të zonës.

21
GUSHT

FESTA E MOLLËS/ PANAIRI I USHQIMEVE TRADICIONALE

KULTURË

Festa e Mollës, ka si qëllim promovimin e produktit vendas, mollës dhe nënprodukteve të saj. Mbledhja e mollëve nëpër ferma të ndryshme në zonat që dallohen për prodhimtarinë e saj, krijon një mundësi argëtimi për turistët vendas dhe të huaj. Me pjesëmarrjen e fermerëve të rajonit, realizohet një panair, ku të gjithë pjesëmarrësit reklamojnë mollët, si edhe produkte të tjera kulinare si verë, reçel, liko, prevede, ëmbëlsira me mollë etj.

6
TETOR

KOLONA NDËRKOMBËTARE E PIKTORËVE "DITËT E MIHOS"

KULTURË

Kolonia e piktorëve, mori emrin e piktorit të famshëm korçar, Vangjush Mio. Piktorë nga Shqipëria dhe jashtë saj janë tashmë pjesë e kësaj kolonie. Ky aktivitet synon jo vetëm vendosjen e urave të komunikimit mes artistëve, por edhe promovimin e vlerave të qytetit.

25-28
TETOR

PANAIRI I FUNDVITIT

TURIZËM

Me sloganin "Festojmë edhe në dimër!", dhe nën dekorin e mrekullueshëm që vesh qytetin në muajin dhjetor, Korça organizon Panairin e Fundvitit, të vetmin në Shqipëri. Atmosferës festive, i shtohen shtëpitë e drurit, lodrat, ëmbëlsirat, pijet tradicionale (vera e nxehtë), mollët e pjekura, gështenjat, muzika në shesh, ekspozita të hapura etj.

3
DHJETOR

PARADA E BABAGJYSHIT

TURIZËM

Çdo 30 Dhjetor, Babagjyshi i vitit të ri me karrocë dhe shumë babagjyshë të tjerë të vegjël bëjnë paradën tradicionale në bulevardet kryesore të qytetit, që finalizohet në sheshin e panairëve, para Katedrales "Ringjallja e Krishtit". Po ashtu ofrohen dhurata, argëtim dhe surpriza për fëmijët në prag të ndërrimit të viteve.

30
DHJETOR



POGRADEEC

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E LIQENIT

TURIZËM

Peizazhi i mrekullueshëm dhe bukuria e këtij Liqeni ju fton në shëtitoren përgjatë bregut të tij të shijoni koncertin dhe një panair me punime artizanale.

21

QERSHOR

FESTA E TETO OLLGËS

KULTURË

Festa e Teto Ollgës nis me prerjen e bostanit, duke na kthyer në kohë vite më parë, kur xhirohej "Zonja nga qyteti". Më pas ju ofron një konkurs me gatimet tradicionale nga bujtinat e Tushemishtit, të cilët kanë ruajtur emrat e filmave dhe personazheve si dhe aktivitetet të larmishme, si panair punimesh artizanale, konkurse kulinarie, kinema verore etj.

21-22

KORRIK

KORANI I LIQENIT

KULTURË

Korani i Liqenit të Pogradecit nuk është unik vetëm në Shqipëri por edhe në botë. Kjo ditë mbledh shumë vizitorë, të cilët shijojnë peshkun e Koranit dhe mjeshhtërinë e gatimit pogradecar të tij.

13-15

GUSHT

KONKURSI I VERËRAVE

KULTURË


Prodhimi i verës së bashku me vreshtarinë janë disa nga traditat dhe zakonet e shumta të jetës së përditshme të qytetit të Pogradecit. Në vazhdim të traditës pogradecare, organizohet konkursi i promovimit të verës më të mirë.

16

DHJETOR

MALIQ


KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E 1 MAJIT NË ATRAKSIONIN TURISTIK TË "PYLLIT TË FAZANËVE"

TURIZËM

Kjo festë e kthyer në traditë viteve të fundit zhvillohet në Pyllin e Fazanëve nëpërmjet realizimit të shfaqjeve artistike kulturore, duke bërë të mundur tërheqjen e shumë vizitorëve vendas dhe të huaj, duke e bërë kështu këtë ambient një atraksion turistik me shumë potencial zhvillimi.



1
MAJ

FESTA E SHËN TRIADHËS

TURIZËM

Festa e "Shën Triadhës" është një festë tradicionale fetare nga më të hershmet dhe më të rëndësishmet e fshatit Zvirinë. Kjo festë e cila i përket fesë Orthodhokse pason dyzet ditë pas Pashkës së Madhe. Në këtë festë organizohet një koncert artistik i cili në repertorin e tij përfshin performanca të ndryshme si: valle të zonës, këngë të karakterit fetar dhe historik, fjalime artistike dhe recitime. Në festë do të ekspozohen gatimet tradicionale, zbulime arkeologjike dhe fotografi të vjetra etj.



20
MAJ

FESTA E TRËNDAFILAVE

KULTURË

Bota nuk do të kishte kuptim pa lulet dhe e bukura nuk do të kishte simbol të saj më të denjë për ta përfaqësuar, se trëndafil. Bëhuni pjesë e kësaj feste kulturore me llojet e ndryshme të trëndafilave dhe produkte të krijuara prej tij.




27
QERSHOR

FESTA E BUKËS SË RE

TURIZËM

Në fshatin Libonik është bërë traditë festa e korjes së grurit, si një ngjarje që sjell gëzimin e bukës së re dhe prodhimit të mbarë. Kjo festë shoqërohet me panairë të varieteteve të ndryshme të brumit, nën tingujt e serenatave korçare dhe valleve tradicionale.



16
GUSHT

PANAIRI I ËMBËLSIRAVE

TURIZËM

Panairi i ëmbëlsirave, prodhimeve bujqësore, blegtorale dhe bletërritësve në edicionin i tij të 11-të, zhvillohet në muajin shtator me pjesëmarrjen e të gjitha njësive administrative. Nga ky vit, do të prezantohen edhe punime artizanale, duke synuar tërheqjen e interesit të turistëve, nëpërmjet ekspozimit të punimeve me dorë.



27
SHTATOR

TË FESTOJMË SËBASHKU

TURIZËM

Kjo festë konsiston në panairin e ëmbëlsirave, produkteve bujqësore, prodhimeve blegtorale, si dhe bletërritësve.

27
SHTATOR

GJIROKASTËR

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTIVALI MBARËKOMBËTAR FOLKLORIK

TURIZËM

Festivali Folklorik Kombëtar në qytetin-muze të Gjirokastrës, është një nga aktivitetet më të rëndësishme për traditën, kulturën dhe folklorin shqiptar. Qëllimi kryesor i këtij festivali është pasqyrimi i gjerë i gjinive të folklorit dhe vlerave të tij. Ky festival ka gjithashtu si qëllim të mbrojtë dhe të promovojë vlerat më të mira muzikore, koreografike, etnografike të krijuara prej shekujsh.



10-16
MAJ

FESTOJMË SË BASHKU NË DIVANIN LUNXHELOT

TURIZËM

Zona e Lunxherisë ju fton të uleni në një divan dhe të njiheni me kulturën e saj, e cila karakterizohet nga kostumet popullore, traditat muzikore, zakonet rajonale, si dhe kulinaria e pasur me produktet lokale.




15
GUSHT

FESTA E QIFQISË

KULTURË

"Festa e Qifqisë" është event i më i shumëpritur në Gjirokastrë dhe një prej gatimeve tradicionale më të famshme. Gatimi tradicional i qifqive në Sofrën Gjirokastrite shoqërohet me ushqim, muzikë, pije dhe shumë argëtim. Amvisat gjirokastrite gatujnë këtë gatim tradicional për vizitorët e turistët e shumtë.



25-28
GUSHT

DROPULL

KALENDARI I FESTAVE 2019



GATIME TRADICIONALE

TURIZËM

Me rastin e ditës ndërkombëtare të monumenteve të kulturës do të bëhet çelja e sezonit turistik. Festa synon të promovojë rëndësinë e aktiviteteve dhe agroturizmin brenda dhe jashtë vendit. Në aktivitet marrin pjesë edhe përfaqësues të zyrave turistike greke. Aktiviteti do të shoqërohet me vizita në monumentet kulturore dhe natyrore të zonës dhe do të shoqërohet me një drekë me gatime dhe muzikë tradicionale.

19
MAJ



PËRMET

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA BOTËRORE E UJIT

TURIZËM

Gjatë kësaj dite zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me përdorimin e ujit, si dhe aksione pastrimi të luginës Vjosë.



22
MARS

ÇELJA E SEZONIT TURISTIK

KULTURË

Përmeti fton për të festuar këtë ditë qytetarët përmetarë dhe jo vetëm, në të cilën bëhet promovimi i produkteve tipike artizanale, kulinarisë, si dhe pikat turistike.



27
PRILL



DITËT NAIMJANE (Dita e Vëllezërve Frashëri)

KULTURË

Në komunën Frashër çdo vit në datën 25 Maj organizohet një festë e madhe kulturore për ndër të vëllezërve Frashëri. Kjo datë i kushtohet datëlindjes së rilindasit dhe poetit të madh Naim Frashëri (25 Maj 1846). Në këtë ditë kujtohen edhe të tjerë patriotë si vëllezërit Abdyl dhe Sami Frashëri, Mithat Frashëri etj. Manifestimi zhvillohet në lëndinën para shtëpisë ku ata lindën dhe u rritën. Rreth 40 vjet më parë u vendos që kjo shtëpi të kthehej në muze në mënyrë që çdokush të ketë mundësinë ta vizitojë për të krijuar idenë sesi jetonte familja Frashëri.



25
MAJ

FESTA E VERËRAVE DHE FESTIVALI MULTIKULTUROR

KULTURË

Festa e Verërave, një aktivitet ky që përfshin të gjithë prodhuesit e verës dhe Shoqatat e vreshtarëve të rrethit. Ky aktiviteti zhvillohet për të reklamuar dhe promovuar produktet tipike lokale.



2-15
QERSHOR

GATESAT E GJYSHEVE

TURIZËM

Njohur si njerëz veçanërisht mikpritës, banorët e Kosinës që jetojnë në zona të largëta, ende mbajnë dhe praktikojnë vlerat e vjetra dhe unike të mikpritjes. Panairot e kuzhinës të servitura gjatë kësaj dite janë një mënyrë interesante për të tërhequr sa më shumë turistë në këtë zonë.

14
GUSHT



FESTA PËRMETARE

TURIZËM

Zhvillohet në muajin gusht pasi janë kthyer shumica e emigrantëve. Në sheshin e qytetit zhvillohet një koncert festiv me këngëtarë të ftuar dhe në videoprojektor, shfaqen atraksionet turistike dhe video/kujtime të Përmetit.

15
GUSHT



FESTA E BEKTASHINJVE

KULTURË

Një ndër ditët e shënuara të kalendarit për besimtarët bektashinjë është festa e Ashures. Ceremonia e kësaj feste organizohet në Teqenë e Ali Postivanit në Përmet, një ndër komplekset më të mëdha të këtij besimi. Pjesëmarrja e gjerë e besimtarëve, si dhe urimet e përcjella për paqe e humanizëm mes njerëzve, janë simbolika e vërtetë e festës.

5
SHTATOR



TEPELENË

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTIVALI I PAN-IT

TURIZËM

Mbajtja gjallë e traditës pastorale të zonës duke promovuar zakonet dhe mënyrën e jetës të lidhur ngushtë me shtegtimin e kopeve në kullota alpine. Përpara nisjes së këtij shtegetimi nga banorët mendojmë që të sjellim së bashku racën më të mirë të cjapit të zonës, duke bërë një lloj konkursi midis blegtorëve mbi Cjapin më të mirë. Ky ritual do të jetë i lidhur edhe me traditën vendase të Kultit të Panit, perëndia mbrojtëse e barinjve, si dhe me orakullin e Lisave të Shenjtë ku banorët ende falen edhe sot, duke mbajtur gjallë një traditë disa mijëvjeçare.

6-7
QERSHOR



VLORË

KALENDARI I FESTAVE 2019



KANINA FESTON

TURIZËM

Kanina, fshati që qëndron si ballkon mbi Vlorë, me një pamje të mrekullueshme mbi qytet, fton për të festuar në kalanë e saj qytetare nga gjithë Shqipëria, si dhe banorë vendas.

22
PRILL

KARNAVALET E NARTËS

KULTURË

Karnavalet janë prej vitesh një festë tradicionale e fshatit Nartë. Festa e cila zgjat tri ditë dhe tri netë, shoqërohet me kërcime të banorëve në rrugët e fshatit, veshur me kostume tradicionale.

PRILL

MOTOFEST

SPORT

Ky aktivitet organizohet edhe në Shqipëri prej 8 vitesh. Motofest është një eveniment plot me risi, i cili nga viti në vit tërheq rreth tij gjithmonë e më shumë adhurues dhe ndjekës. Organizimi i një eventi me përmasa kaq të mëdha me rastin e hapjes së sezonit të pushimeve për qytetin e Vlorës është një vlerë e shtuar dhe një ngjarje mjaft tërheqëse për pushuesit dhe vizitorët e qytetit. Eventi mundëson krijimin e një destinacioni të përbashkët për të gjithë dashamirësit e motorrave dhe festës

12
MAJ

ULLIRI I BREGUT

TURIZËM

Festa do të fillojë në mëngjes me pazarin e produkteve bio dhe prezantimin e përvojave të disa fermerëve ulli-kulturës. Do të zhvillohet kampionati i tërheqjes me litar, ku fituesi vlerësohet me kupën "Dega e Ullirit". Gjatë pasdites panairi do të shoqërohet me këngë e valle tradicionale gjithashtu dhe me gara e kampionate në disiplina sportive si: not, gara me kanoa, lojëra me litar, volejboll etj.

28-29
KORRIK

NGJALA E NARTËS

TURIZËM

Laguna a Nartës është mjaft e njohur për kultivimin në sasi të madhe të ngjalave, si dhe gatimeve tradicionale të tyre. Kjo ditë festohet me një pjesëmarrje masive të banorëve të zonës dhe jo vetëm, ku kanë mundësinë të shijojnë këto gatime.

5-8
GUSHT

DITËT E SHËN MERISË NË MANASTIRIN E ZVËRNECIT

KULTURË

E njohur si një prej datave më të rëndësishme të kalendarit ortodoks, kjo festë kremtohet në Manastirin e Zvërnecit me pjesëmarrje masive nga besimtarët dhe jo vetëm.

14-15
GUSHT

FESTA E GJENERATAVE

TURIZËM

Kjo festë vjen në kalanë shekullore të Kaninës, në një nga zonat më të mrekullueshme dhe historike të Vlorës, ku turistë dhe qytetarë do të argëtohen me ritmet e muzikës popullore vlonjate, këngë polifonike, valle si dhe të shijojnë gatimet tradicionale të zonës. Kjo festë gjithashtu bën të mundur dhe takimin e brezave, pasi do të ofrojë një program të larmishëm për çdo grup moshe.

15
GUSHT



PUTARKA E QEFULLIT

TURIZËM

Panairi rajonal konsiston në një pjesëmarrje të gjërë të bisneseve të ndryshme, që kanë të bëjnë me ekspozimin e verës, si edhe të produkteve të ndryshme ushqimore.

24-26
GUSHT



ÇELJA E SEZONIT TURISTIK DIMËROR NË LLOGARA

KULTURË

Në çeljen e sezonit turistik dimëror bashkia organizon aktivitete të ndryshme sportive, kulturore, argëtuese, duke mbledhur shumë vizitorë, duke promovuar kështu bukuritë natyrore të Llogarasë.



NËNTOR

SARANDË


KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E MIDHJES

TURIZËM

Kjo festë konsiston në dy ditë festime mes gatimeve të midhjes, lundrim në fermat e kultivimit të midhjes, lojrat e rërës, garat e notit, çmimi Mbretëresha, koncert dhe vënia në skenën e legjendës së Heksës dhe Amilit, konkurse dhe animacione, investime në shërbim të turizmit dhe të përmirësimit të kushteve të fermerëve të midhjes.



12-13

MAJ

PANAIRI I SUVENIREVE ARTIZANALE

TURIZËM

Artizanë nga zona të ndryshme të vendit janë të ndarë në pavione ku prezantojnë punimet në shëtitoren buzë detit. Artizanët shqiptarë sjellin pranë njëri-tjetrit në këtë event kombëtar tradita të ruajtura me fanatizëm e të trashëguara brez pas brezi në punën me dorë: tezgjah, shtiza e filigram, por edhe punime të kryera me teknika më të reja.



16-18

GUSHT

GARA E VELIERAVE TË ZONËS SË JONIT

KULTURË

Festa me e re në qytetin e Sarandës, duket qartë që do të bëhet një traditë e bukur gjithëpërfshirëse. Ky event konsiston në garimin e disa velierave për të parë se kush ka aftësinë për të arritur sa më shpejt. Kjo garë organizohet në Portin e Sarandës, me destinacione të tjera të paditura.




27-28

GUSHT

HIMARË

KALENDARI I FESTAVE 2018



KARNAVALET

TURIZËM

Festa Tradicionale e Karnavaleve, bëhet 40 ditë para Pashkëve. Në këtë ditë kryesisht fëmijët dhe të rinjtë zgjedhin personazhin që parapëlqejnë dhe shëtisin në qendër të zonës.



8
MARS

MJALT 'FEST

TURIZËM

Mjalt'Fest do të zhvillohet në Dhërmi në datat 7 dhe 8 Korrik. Festa fillon pasditen e datës 7 Korrik me hapjen e panairit të mjaltit i cili do të zgjasë gjatë dy ditëve, dhe në fund do të klasifikohen gjithë varietetet e mjaltit të kësaj zone. Do të zhvillohet konkursi "Mjalt'Mir' Dhërmi", fituesi do të mbajë kupën deri në panairin e ardhshëm. Festa do të shoqërohet nga aktivitete të ndryshme kulturore e sportive, ekspozita, kampionate shahu, gjuajtje në shenjester, kampionati i notit, shfaqje muzikore dhe DJ etj.




7-8
KORRIK

DITËT BAROKE

KULTURË

"Vox Baroque Festival", synon të promovojë historinë dhe identitetin kulturor të vendit në mesin e audiencës kombëtare dhe ndërkombëtare, duke inkurajuar turizmin kulturor dhe lokal. Përveç kësaj, bashkëpunimi me artistë ndërkombëtarë të specializuar në repertorin barok, synon krijimin e lidhjeve më të forta midis muzikantëve shqiptarë dhe kolegëve të tyre evropian, iniciativave të ngjashme të artit dhe institucioneve akademike, që angazhohen në kërkimin e muzikës baroke. Imazhet pozitive të kulturës shqiptare, artit, trashëgimisë, dhe krijimtarisë promovuese.



FINIQ

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA NDËRKOMBËTARE E MONUMENTEVE DHE SITEVE

TURIZËM

Organizatat e trashëgimisë botërore ICOMOS dhe UNESCO, që prej vitit 1982 kanë shpallur 18 Prillin si Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve. Është dita ku popujt dhe kombet në të gjithë botën kthejnë vëmendjen nga trashëgimia e tyre kulturore, njihen me vlerat e saj dhe sensibilizohen për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave.

18
PRILL

FESTA E VERËS (Kantina Isak Vrion)

TURIZËM

Shqipëria është një nga vëndet më të vjetra të prodhimit të verës. Kantina Isak Vrion prodhon një shumëllojshmëri verërash, raki të llojeve të ndryshme, vaj ulliri, uthull, konjak etj., e cila ndodhet në zonën industriale Vrion-Sarandë.

15
SHTATOR

KONISPOL

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E MANDARINAVE

TURIZËM

Kjo festë ka të bëjë me promovimin e prodhimeve bujqësore dhe blektorale. Karakteristikë në këtë ditë është vizita në blloqet e agrumeve, ku vrojtohet procesi i vjeljes së mandarinës.



NËNTOR

SHKODËR

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA NDËRKOMBËTARE E MONUMENTEVE DHE SITEVE ARKEOLOGJIKE

Në këtë ditë të shënuar Shkodra promovon përmes eventeve vlerat unikale të trashëgimisë kulturore.

KULTURË

18
PRILL

FESTA E SHËN GJERGJIT

Në fshatin Neshat të Qarkut të Shkodrës, në një nga kishat më të vjetra të kësaj zone, qindra besimtarë krishterë kremtojnë festën e Shën Gjergjit. Dita e Shën Gjergjit festohet për të përjetuar daljen e dimrit dhe ardhjen e stinës së pranverës. Shën Gjergji është festë me shume rite: gjelbërim, ndezjen e zjarreve rituale në vende publike, mbledhje lulesh e thurje kurorash nga fëmijët.

KULTURË

5
MAJ

DITA E LULEVE

Shkodra është e njohur ndryshe si “qyteti i luleve”. Tashmë është kthyer në traditë që çdo 6 Maj të festohet “Dita e luleve” në të cilën Shkodra kthehet në një oborr të madh ngjyrash dhe aromash. Si një zonë e lidhur shumë me natyrën dhe artin, në Shkodër numërohen rreth 150 tekste këngësh qytetare, të cilat i janë kushtuar luleve duke e ruajtur kështu në shekuj traditën e bukur të kultivimit dhe përkujdesjes për to. Në këtë aktivitet bëhen një sërë organizimesh artistike, që prej kultivuesve të luleve e deri në paradë me kostume tradicionale.

KULTURË

6
MAJ

DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEUMEVE

Këtë vit Muzeu Historik Shkodër do të organizojë ekspozitën interaktive të produkteve artizanale, të prodhuara nga mjeshtrat shkodranë me titull “Jehona e Zejeve”. Gjatë ekspozitës artizanë të ndryshëm demonstrojnë procesin e prodhimit të produkteve të tyre.

ART

18
MAJ

DITA E LIQENIT

Liqeni i Shkodrës si liqeni më i madh në Ballkan dhe me vlera në ekosistemin natyror ju fton në Shirokë me një atmosferë festive dhe dashamirëse në të cilën do të gjeni grupet artistike si dhe aktivitetet në not, water polo, kanotazh, gara me kanoe etj.

KULTURË

23
QERSHOR

DITA E BJESHKËS

Mes kostumeve popullore, tingujve të çiftelisë dhe traditave të hershme, kjo festë ju fton të shijoni vlerat natyrore, klimaterike, turistike dhe kulturore të zonës.

KULTURË

25
QERSHOR

ZAFEST

FESTIVAL

Në një vend të cilin koha e ka izoluar gjatë dhe që sot përmban në vetvete pasurinë e thesareve të harruara. Vendi ku frymojnë këngët legjendare, tregimet e Orëve, flokët e Zanave, të cilat jetojnë në shpirtin e erës. Është pikërisht Thethi, vendi ku merr jetë "Za-Festival". Një festival që ka si qëllim rizgjimimin e shpirtit të këtij vendi, rikthimin e vëmendjes drejt kësaj perle të veriut të Shqipërisë dhe shndërrimin e saj në pikën e takimit të kulturave të ndryshme përmes artit si gjuhë e përbashkët.

20-22

KORRIK

FESTA E TRASHËGIMISË KULTURORE

Në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të pikave turistike të territorit, do të organizohet një koncert i madh, me muzikë të zgjedhur nga artistë të dimensioneve ndërkombëtare, në një nga pikat strategjike të trashëgimisë natyrore.

KULTURË

30

KORRIK

LOGU I BJESHKËVE

Çdo muaj gusht mbledheshin në Kelmend nuset e reja për të parë kush ishte më e bukura. Kështu, në këtë "Log" gjatë kësaj dite vijnë njerëz nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora, ku bëhet një promovim si i turizmit malor, ashtu dhe i traditës së vjetër kulturore.

KULTURË

10

GUSHT

FESTA E REÇIT TË SHKRELIT

KULTURË

Tashmë është bërë traditë të mbledhurit çdo vit në Reç për të nderuar veprën e atyre burrave dhe burmeshave që ranë heroikisht në luftë kundër pushtuesve për lirinë që gëzojmë sot. Lufta e Reçit e vitit 1943, është prova më e pakundërshtueshme e rezistencës së Reçit dhe mbarë malësorëve tanë kundër pushtuesve fashistë. Ndaj nderimi më i lartë shkon për dëshmorët e lirisë dhe familjet e tyre, e ndërsa ne na mbetet t'i kujtojmë brez pas brezi.

31

GUSHT

DITA E BIÇIKLETAVE

Shkodra është qyteti i parë në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj, që zë fill në shekullin e 19-të. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme, synohet ripërtëritja e traditës, si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës.

KULTURË

20

SHTATOR

AHENGU SHKODRAN

Pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore jomateriale është edhe "Ahengu Shkodran". Zhvillohet çdo vit në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e kësaj pasurie.

KULTURË

29

SHTATOR

BERAT

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E UJIT TË BEKUAR, CEREMONIA E HEDHJES SË KRYQIT NGA URA E GORICËS

Kjo ditë mbledh qindra besimtarë të krishterë. Pas meshës së besimit të kryqit, në orët e para të mëngjesit kryhet riti i hedhjes së kryqit në Lumin Osum, ku të rinjtë sfidojnë temperaturat e ulta dhe ujin e ftohtë për të marrë kryqin e bekuar.

KULTURË



6
JANAR

DITA E HYRJES SË BERATIT NË UNESCO

Organizimi i një sere aktivitete, në kuadër të ditës së përfshirjes Beratit në listën e Trashëgimisë Botërore.

TURIZËM




8
KORRIK

HIKING, KARVAN ME MUSHKA, KAMPING, JOGA

Vizitoni një nga malet më madhështore të Shqipërisë dhe të përjetoni bekimin dhe harmoninë nga faltorja e perëndive duke zotëruar një pamje të gjithë horizontit në shetitjen me hiking, mushka drejt malit të Tomorrit. Gjatë periudhës antike dhe mesjetare dhe në letërsinë romantike ky mal është përfytyruar si Olimpi i Shqiptarëve dhe shtëpia e zanave të maleve, Orakulli që parathote të ardhmen e kombit. Shijoni një natyrë të paprekur nëpërmjet praktikimit të jogas dhe përjetimit të energjisë së malit të shenjtë.

KULTURË



1
QERSHOR

KONKURSI I PRODHIMIT TË VERËS

Çdo vend i botës ka ato rajone ku prodhohet vera më e shijshme e cilësore e vendit, aty ku ka lindur tradita e verës e ku ajo vazhdon të lulëzojë për shkak të përkushtimit të njerëzve, klimës e sekreteve të tjera të këtij zanati të bukur. Në Shqipëri, ky titull i përket Beratit. Me një numër të lartë kantinash të cilat prodhojnë shumë lloje verërash, Berati është kthyer në një destinacion ideal, ku njerëzit kalojnë ditën duke degustuar verën më të mirë në vend dhe ku prodhues të ndryshëm konkurrojnë për verën më të mirë.

KULTURË



27-29
GUSHT

FESTA E ROSHNIKUT

TURIZËM

Festa e Roshnikut zhvillohet në Fshatin Roshnik, Berat, në datat 14-15-16 Shtator. Për të gjithë të pasionuarit e sporteve dhe udhëtimeve në natyrë, do të ketë një sërë ofertash tërheqëse si: ecje, udhëtime informuese në lidhje me florën dhe faunën e zonës, udhëtime me biçikleta, etj.



DITA E GATIMEVE TRADICIONALE

KULTURË

Si një qytet që ruan çdo traditë në kulturë, Berati ruan edhe një tjetër traditë, atë të gatimit tepër të veçantë, të trashëguar në vite. Në këtë panair gatimet janë nga më të larmishmet, por epiqendra është përsheshi me gjelin e detit dhe kulaçi.



DITA E TURIZMIT

TURIZËM


Në këtë ditë do të organizohen fushata sensibilizuese për promovimin e zhvillimit të turizmit në një mjedis të pastër. Gjithashtu, në këtë ditë do të shpërndahen dhe materiale promovuese për turizmin në vend.



20
DHJETOR

SKRAPAR

KALENDARI I FESTAVE 2019



KAMPIONATI RAJONAL I RAFTINGUT

SPORT

Nëpërmjet aktiviteteve të këtij sporti, të kombinuara dhe me aktivitete të tjera, synohet ndërgjegjësimi i komuniteteve rreth sporteve ujore. Nuk mungon dhe prania e shoqatave të huaja të rafting.



10
QERSHOR

FESTIVALI I ALPINIZMIT

TURIZËM

Organizohet në bashkëpunim me shoqatat e alpinizmit, në kanionet e Gradecit, pranë shpellës së Pirogoshit. Ky festival bashkon alpinistë, njerëz pasionantë të sporteve që kanë lidhje të forta me malin.



15
GUSHT

FESTIVALI I RAKISË "SKRAPARI NË GOTË"

KULTURË

Stina e vjeshtës në Skrapar njihet ndryshe si stina e rakisë. Skrapari është një rajon që nuk njihet vetëm për mirëpritjen dhe për traditën e tij, por shquhet edhe për prodhimin e rakisë. Për të mësuar sekretet e prodhimit të rakisë më të mirë dhe për të shijuar muzikën e vallet më të bukura, sjellim Skrapari n'Gotë, festë tipike e zonës së kanioneve magjike të Osunit.



21
SHTATOR

FESTA E ARRËS

TURIZËM

Zona e Skraparit dhe fshatrat
përreth tij dallohen
për kultivimin e arrës dhe
prodhimin cilësor të rakisë së
saj.

10
TETOR



KUÇOVË

KALENDARI I FESTAVE 2019



SOFRA KUÇOVARE

TURIZËM


Sofra Kuçovare është kthyer në një traditë shumë të bukur jo vetëm për banorët e Kuçovës, por për të gjithë ata që janë të interesuar të njohin traditën ushqimore, muzikën folklorike, apo veshjet popullore të trevave të ndryshme. Në këtë ditë festive banorët dhe bizneset familjare të kësaj zone ofrojnë ushqime tradicionale të shoqëruara me muzikë dhe veshje karakteristike të zonës.

18
TETOR



LEZHË

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTIVALI I GASTRONOMISË "LEZHA GATUAN"

KULTURË

Gastronomia është venë në qendër të vëmendjes për të promovuar qytetin e Lezhës më 6 Maj. Festivali i Gastronomisë "Lezha Gatuan", promovon në qytetin verior, këtë vlerë të spikatur të zonës me një menu plot krijimtari dhe shije, pa harruar gatimet tradicionale Bio. Më shumë se një garë, festivali i gastronomisë synon promovimin e gatimeve të traditës dhe të kuzhinës moderne nga kuzhinierët më të njohur vendas me pjata të veçanta dhe tërheqëse.

6

MAJ

FESTA E LULEVE

TURIZËM

E kthyer tashmë në një festë kulinarie për qytetin e Lezhës dhe zonat rreth saj, "Festa e Luleve" përmbledh në vetvete traditën, artin dhe kulturën vendase.

9

MAJ

QEFULL N'TAVË

KULTURË

Ndër gatimet që spikasin në këtë zonë, i preferuar është dhe qefulli, i cili shërbehet i freskët dhe në varietete të ndryshme.

13-14

GUSHT

MIRDITË

KALENDARI I FESTAVE 2019




MIRDITA TURISTIKE

TURIZËM

“Mirdita Turistike” me ritualet e dasmës tipologjike të Mirditës, e organizuar nëpër kullat tipike të krahinës dhe me plot aktivitete kulturore.

5

KORRIK



KURBIN

KALENDARI I FESTAVE 2019



PANAIRI PROMOVUES I PRODHIMEVE TRADICIONALE

TURIZËM

Qëllimi i këtij panairi është promovimi i bizneseve dhe prodhimeve të ndryshme si: prodhimet agro-bujqësore, prodhimet e etnografisë kulturore, si dhe të kulinarisë Kurbinase.

8

SHTATOR



DIBËR

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA FETARE E SHËN KOLLIT

KULTURË

Festa e Shën Kollit festohet në Komunën e Selishtës për të simbolizuar ardhjen e pranverës, duke qenë se pranvera vjen pak më vonë në këto zona të larta. Shën Kolli njihet e festohet edhe në vende të tjera të Shqipërisë, si Voskopojë, Tiranë, Korçë, Shkodër, etj.

20-25
MAJ

PANAIRI I QERSHIVE

KULTURË

Organizohet çdo vit në periudhën maj-qershor që është edhe koha e vjeljes së qershive. Në këtë panair fermerët tregtojnë dhe promovojnë produktin e qershisë.

3
QERSHOR

FESTA E DRINIT

KULTURË

Festa e Drinit, ju fton të largoheni nga vapa dhe të hapni sezonin turistik veror në Dibër në freskine e Drinit. Ambienti i mrekullushëm në Muhurr do të jetë mikpritës me panairë të produkteve artizanale, garat e notit, muzikë popullore, lojra sportive etj.

1
KORRIK

FESTA E BJESHKËS

KULTURË

"Festa e Bjeshkëve", një aktivitet për të promovuar bjeshkët e mrekullueshme të Malësisë sonë. Ky aktivitet do të shoqërohet me këngë, valle, lojëra popullore dhe një panair ushqimor me prodhime tradicionale të zonës.

7-13
KORRIK

FESTA E TË VJELAVE

TURIZËM

Ky aktivitet zgjat 1 deri në 3 ditë. Në bulevard vendosen tendat për ekspozimin e produkteve bujqësore, blegtorale, si dhe gatimeve apo punimeve tradicionale të zonës. Në shumë raste zhvillohet njëkohësisht me festivalin folklorik “Oda Dibrane”, duke qenë se ka një pjesëmarrje të gjerë nga dibranët dhe jo vetëm. Ndër produktet më kryesore në këtë panair janë: mollët, dardhët, ftonjtë, arrat, prodhime blegtorale si djath dhe apo deleje, mjaltë, raki e llojeve të ndryshme, ëmbëlsira të shumëllojshme, turshi, pastërma, jufka etj.

6

TETOR



MAT

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E MAÇUKULL-IT

TURIZËM

Promovim i turizmit malor,
përmes aktiviteteve sportive,
panaireve, koncerteve,etj.

14
TETOR



FIER

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E LULESHTRYDYES

KULTURË


Festa e luleshtrydhes organizohet në kuadër të turit etnokulturor "Hajd dalim nga Myzeqeja". Kjo festë tipike fshati mbledh dhe promovon një prej sukseseve të fermerëve të zonës Kafaraj, luleshtrydhes. Ky produkt shqiptar, "Made in Kafaraj" është bërë nga më të famshmit në Shqipëri dhe mbush sot edhe tregjet e huaja.



SOFRA ILIRE

KULTURË

"Sofra ilirie", është një aktivitet i trashëgimisë kulturore që zhvillohet çdo vit gjatë javës së fundit të Majit dhe synon prezantimin e vlerave të turizmit në qarkun e Fierit. Mikpritja, bujaria dhe tradita janë shtyllat e këtij aktiviteti në të cilin marrin pjesë grupe të ndryshme të muzikës popullore nga Myzeqeja, Mallakastra, Labëria, Çamëria, Kosova etj.



FESTIVALI BYLIS-FONIA

KULTURË

Pagëzuar simbolikisht "Bylis-Fonia", Festivali Polifonik Ndërkombëtar zhvillohet në Bylisin antik dhe për nga forma është tepër unik. Në këtë aktivitet grupet polifonike pjesëmarrëse e përcjellin traditën shekullore shqiptare në pode të ndryshme të improvizuara në qendrën e qytetit të Bylisit.



FESTA E VALËVE

KULTURË

Çelja e sezonit turistik bregdetar në Fier, sjell një festë të vërtetë me në qendër detin, diellin, rërën dhe argëtimin. Lojëra sportive (futboll, volejball, basketboll), aeronautikë, lojëra dhe gara sportive në ujë etj.



FESTA E GRURIT, MOJ MYZEQE

KULTURË

Si një traditë të hershme zona e Myzeqesë ju ftonë në një nga veprimtaritë më të rëndësishme të saj korrien dhe shirjen e grurit. Festa do të shoqërohet me demonstrime të korries së grurit, këngëve dhe valleve, por edhe gatimeve tradicionale që karakterizojnë këtë moment shumë të bukur tradicional popullor.

8

QERSHOR

FESTA E SHQIPES (Hajde dalim nga Myzeqeja)

TURIZËM

Është një festë tipike tradicionale e zonës së Libofshës. Është një festë popullore, e cila ka në qendër ngjarjen historike të çeljes së shkollës së parë shqipe për gjithë zonën e Myzeqesë, si dhe promovimin e monumenteve të kulturës dhe natyrës që ka kjo zonë. Festa promovon agroturizmin e zonës me kantinat e famshme të verërave, si dhe ndërthurret me gatimet tradicionale të zonës.

2

NËNTOR

SOFRA BUJARE

KULTURË

Festa përkon me sezonin e vjeljes së ullirit, dhe ka si qëllim evidentimin dhe promovimin e turizmit me Siqecën, fshatin e përzgjedhur në projektin e "100 fshtarave turistik", vlerat shpirtërore, objektet kulturore, historike, traditat, zakonet, si dhe prodhimet bujqësore e blegtorale të gjithë zonës.

20

TETOR

FESTA E GJELIT TË DETIT

KULTURË

Është një traditë e re festimesh në zonën e Cakranit. Festa promovon sipërmarrjen e suksesshme të banorëve të Cakranit në mbarëshkrimin e gjelit të detit, nëpërmjet paradave simbolike të tufave të mëdha në këtë zonë. Aktiviteti ndërthurret dhe me panairin e gatimeve tradicionale të gjelit të detit, ndërthurrur bukur me koncerte festive.

7

DHJETOR



DIVJAKË

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E LAXORES

TURIZËM

Festë e cila simbolizon ardhjen e verës. Gjatë festës fëmijët shkojnë për vizitë në çdo shtëpi, duke kënduar këngë tradicionale dhe ndërkohë marrin dhe dhurata.



28
SHKURT

FESTA E BOSTANIT

KULTURË

Festa e bostanit ju pret në Parkut Kombëtar të Karavastasë ku prodhues dhe përpunues të bostanit, do të ekspozojnë dhe tregtojnë për pushuesit, varietete të ndryshme të bostanit, gatime me bazë shalqini dhe pjepr, si dhe lloje të ndryshme sallatash, tortat me bostan, gliko të ndryshme dhe ëmbëlsira të tjera me këtë bazë.



25-26
KORRIK

DITA E PELIKANIT

KULTURË

Pelikani kaçurrel, apo i njohur ndryshe si pelikani dalmat, është simbol i Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, tashmë duket se ka ditën e vet kombëtare. 10 Maj është tashmë "Dita e Pelikanit", ditë ku organizohen aktivitete ndërgjegjësuere dhe promovuese të vlerave natyrore dhe ekoturistike të këtij lloji në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta si dhe në zonat e tjera ligatinore të Shqipërisë, ku jeton kjo specie. Shpallja e saj nënkupton organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe promovuese të vlerave natyrore dhe ekoturistike të këtij lloji në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta si dhe në zona të tjera ligatinore të Shqipërisë, ku jeton kjo specie.



10
MAJ

FESTA E NGJALËS

KULTURË

Ngjala e Lagunës së Karavastasë është e famshme në të gjithë vendin. Ndaj në traditën myzeqare në këtë të vit, banorët organizojnë një festë kushtuar kësaj specie. Festa shoqërohet me këngë e valle popullore, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë, ku nuk mund të mungojë as e famshmja "Valle e Ngjalave", si dhe me shijimin e gatimeve tradicionale të ngjalës.



29
NETOR

Arti
GATIMIT

PATOS

KALENDARI I FESTAVE 2019



PATOSI N'FESTË

TURIZËM

Festa përkon me përvjetorin e krijimit të Patosit. Në kuadër të kësaj feste gjatë gjithë ditës do të organizohen një sërë aktiviteteve kulturore e sportive : simpoziumi historik "si qytet naftëtar", ekspozita me punime artistike të shkollave të qytetit, finalja e aktivitetit sportiv "Kupa Naftëtar" dhe në mbrëmje koncerti festiv. Gjatë shfaqjes së koncertit qytetarët do të shijojnë pije dhe produkte zgare nga bizneset lokale në bulevardin kryesor të qytetit.

23
QERSHOR

BREZ PAS BREZI MYZEQAR!

TURIZËM

Kjo festë përkon me Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, e cila ka si qëllim evidentimin dhe promovimin e vlerave shpirtërore, objektet kulturore, historike, traditat, zakonet dhe prodhimet bujqësore e blegtorale të Zharrëz. Do të përfshihen disa veprimtari: panairi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, objekteve të vjetra etnografike, kuzhina tradicionale e zonës, ekspozim i punimeve artizanale, etj.

29
SHTATOR

*Ena Tosk
Photograph*

ROSKOVEC

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E SERAVE TË GJELBËRTA

TURIZËM

Kjo festë e cila është konceptuar si festivali i frutave dhe perimeve ka si qëllim promovimin e prodhimeve të serave si dhe prodhimet bujqësore të zonës.

25
MAJ

FESTA E ULLIRIT


TURIZËM

Zhvillohet në një nga vendet më piktoreske të bashkisë Roskovec. Edhe këtë vit festa do të zhvillohet në kishën 700- vjeçare të Shën Kollit, Kurjan. Gjatë kësaj dite do të promovohen prodhimet bio të vajit të ullirit. Festa është gërshetuar me prodhime të tjera të zonës dhe muzikë.

25
TETOR

BELSH

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E BALONAVE

KULTURË

Në këtë aktivitet, marrin pjesë me qindra nxënës dhe zhvillohet në malin e Gradishtës në formën e një gare mes nxënësve për ngritjen e balonave. Aktivitete të kësaj natyre synojnë që ti shërbejnë, jo vetëm argëtimit dhe edukimit, por njëkohësisht të tërheqin edhe turistë për t'u bërë pjesë e kësaj feste.

4

MAJ

FESTIVALI I AFËRDITËS

TURIZËM

Bashkia Belsh në bashkëpunim me "Tourism Investment and Finance Fund (TIFF)" organizon në bregun e liqenit piktoresk të Seferanit Festën e Afërditës. Në ditën e parë të festës promovohen aftësitë artistike të zërave të rinj, duke sjellë vlera të ndjeshme në jetën artistike të Dumresë. Festa e Afërditës është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme, duke promovuar kështu gjurmë të qytetërimit të lashtë në këtë zonë, si dhe historinë e pasur të saj.

20-22

MAJ

NYMFA E LIQENEVE

KULTURË

"Nymfa e Liqeneve" është në mbështetje të legjendës për nymfat e liqeneve, pasi në territorin e Bashkisë së Belshit ka mbi 84 liqene natyrore. Kjo festë ka për qëllim promovimin e bukurive natyrore të liqeneve të mrekullueshme të Belshit, promovimin e kulturës, traditës, veshjeve popullore të zonës, të gatimeve dhe kulinarisë, si dhe prodhimeve bujqësore dhe blegtorale bio, me qëllim tërheqjen e sa më shumë vizitorëve për turizëm liqenor.

14-15

SHTATOR

SUSHI DHE YOGA

TURIZËM

Data 4 Nëntor është dita që i dedikohet rigjenerimit shpirtëror, relaksit, dhe shëndetit mendor dhe fizik. Kjo ditë fillon me një seancë Yoga në mëngjes mbi verandën e mrekullueshme të Bujtinës së Trëndafilave. Më pas vijon me një shëtitje në fushat e Dumresë plot ullinj, dhe porosisim vajin tonë të ullirit tek fabrika e fshatit. Pas degustimit të çajit të shafranit, mjaltit dhe kulaçit bejmë një seancë shplohëse meditimi. Në drekë shijojmë ushqimet e Zejtarisë së Fshatit. Dita mbyllet me një klasë gatimi të hapur dhe falas për Sushi.



4

NËNTOR

VERË DHE PIKTURË

TURIZËM

Në këtë festë çdo pjesëmarrës është i pajisur me kavaletën, telajon, penelat dhe bojrat dhe pikturon nën drejtimin e mjeshtrave të pikturës shqiptare. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, bëhet ndërkohë dhe degustimi i verërave më të mira të prodhuara në Seferan.



22

DHJETOR

CËRRIK

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E SHELGUT

KULTURË

Kjo festë e ka burimin nga formimi i batalionit partizan "Dumreja" e njohur ndryshe si "Festa e Shelgut". Në nder të veteranëve të batalionit të dumresë në këtë festë organizohen aktivitete artistike dhe kulturore të shoqëruara me muzikë dhe valle, sëbashku me një panair ku promovohen produktet e zonës.



14
MAJ

FESTA E RIGONIT

TURIZËM

Fshati Xherie është prodhuesi më i madh i rigonit në bashkinë Cërrik dhe më gjërë. Kjo festë e kthyer tashmë në traditë mbledh kultivuesit e rigonit, si dhe banorët e zonës.



14
GUSHT

GRAMSH

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E UJËVARËS SË SOTIRËS

KULTURË

Ujëvara e Sotirës është një nga perlat e natyrës sonë, klasifikuar vite më parë si monument natyre. Gjatë kësaj dite pjesëmarrësit kanë mundësinë të shijojnë pamjen piktoreske të ujëvarës, si dhe gatimet tradicionale të zonës.

7

PRILL

FESTA E "UJVARËS SË SOTIRËS"

KULTURË

Pamja piktoreske e Ujvarës së Sotirës si pjesë e natyrës mahnitëse shqiptare ju fton në një ecje që shërben si një lëvizje sportive, të provoni gatimet tradicionale të zonës dhe të shijoni performancën e grupeve artistike.

10

QERSHOR

NATYRA-FEST

TURIZËM

"Natyra Fest" tashmë është kthyer në një festë tradicionale për qytetarët e Gramshit dhe për vizitorët e shumtë të tij. Kjo festë fillon në sheshin kryesor me anë të Festivalit Folklorik dhe vazhdon deri në orët e vona të natës në sheshin kryesor të qytetit me koncert me muzikë të lehtë. Më pas në këtë festë organizohet Panairi i Produkteve Vendase, në të cilën do të ekspozohen modelet më të spikatura të prodhimit vendas si bylmet, mjalt, gatime tradicionale, verë, raki, lëngje frutash, qëndistari, gdhendje në gur e në dru etj.

25

MAJ

NATYRA FEST

FESTA E LIQENIT TË ZI

TURIZËM


Frekuentohet për gati një muaj rresht nga mijëra njerëz nga të gjitha trevat e Shqipërisë, për t'u argëtuar dhe kuruar në këtë mjedis.

1-31

GUSHT

PRRENJAS

KALENDARI I FESTAVE 2019



KAFJA E SKROSKËS

KULTURË

Çdo verë fshati organizon një festë e cila mbledh bashkë 11 fise, siç kanë qenë dikur. Banorët mbledhen së bashku për të mbajtur te forta brez pas mbrezi lidhjet dhe traditat e tyre familjare me ato të zonës së tyre. Festa ka marrë emrin e traditës më të lashtë të kësaj zone, atë të kafes ku miku pritej e përcillej me kafe.



15
GUSHT

PANAIRI: TRADITAT E ZONËS

TURIZËM

Rrajca, Qukësi dhe Stravaj secila prej këtyre njësive administrative kanë një mozaik të larmishëm dhe të veçantë në etnografi, valle, këngë, agroturizëm (gatime të ndryshme), zejтари, prodhime bujqësore etj. Ky panair organizohet me qëllim promovimin dhe nxitjen e trashëgimise së traditave tona në këto fusha.



29
SHTATOR

ELBASAN

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E VERËS

KULTURË

Festë me origjinë të lashtë, e cila e ka krijuar tashmë traditën e saj në qytetin e Elbasanit dhe jo vetëm, në nderim të natyrës së bukur dhe bimësisë që merr jetë në këtë datë. Simboli i kësaj feste është "ballokumja", ëmbëlsirë tradicionale elbasanase.

13-14
MARS

DITA E BIOTURIZMIT

TURIZËM

Tashmë e kthyer në traditë, kjo festë ka për qëllim promovimin e produkteve lokale BIO, për një zonë kodrinoro-malore me larmi produktesh të një cilësie të lartë

4-5
MAJ

FESTA E SHIJONIT

TURIZËM

Festa e Shijonit në Komunën Bradashesh, Elbasan fton çdo 3 dhe 4 Qershor në Kishën e Shën Gjon Vladimirit vizitorë të shumtë vendas e të huaj, duke e konsideruar këtë ditë si një ditë simboli paqeje dhe vëllazërimi. Kjo ceremoni vazhdon në natyrës nën tingujt e muzikës tradicionale, vallet e këngët popullore, veshjet popullore dhe punime artizanale të kësaj zone.

4
QERSHOR

FESTE E EMIGRANTIT

TURIZËM

Festë që prej vitesh është kthyer në traditë dhe nga viti në vit është pasuruar gjithnjë e më shumë. Veç këngëve e valleve popullore, gjatë kësaj feste evidentohen dhe veshjet popullore, të cilat shquhen për veçantinë e kompozimit, si dhe ushqimet tradicionale.

26
GUSHT

DITA E TURIZMIT KURATIV

TURIZËM

Llixhat e Elbasanit janë shumë të famshme për vlerat kurative që ato mbartin. Për t'i dhënë një promovim më të madh këtij "produkti" turistik shumë të rëndësishëm, Bashkia Elbasan organizon festën e Turizmit Kurativ, në bashkëpunim me hotelet dhe resortet që ushtojnë aktivitet në Tregan.

14-15
SHTATOR

LIBRAZHD

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E LULEVE

KULTURË

Festa e Luleve është festa për të kujtuar ardhjen e Verës si dhe shënon hapjen e sezonit turistik në këtë zonë. Bukuria e kësaj feste qëndron se banorët e zonës mblidhen nga qytete të ndryshme dhe festojnë nën tingujt e muzikës tradicionale, ushqimit të zonës dhe promovojnë vlerat natyrore ekoturistike. Kjo festë shoqërohet edhe me shfaqje folklorike, këngë e valle popullore të zonës së Librazhdit.

6
MAJ

FESTA E PARKUT KOMBËTAR SHEBENIK-JABLLANICË

TURIZËM

Bukuritë mahnitëse të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dallohet për vlera të larta turistike, flora, fauna, monumente të shumta natyrore dhe mbi 14 liqene akullnajore. Të gjitha këto vlera turistike promovohen në Festën e Parkut, ku zhvillohen koncerte artistike me motive popullore tradicionale të zonës, panaire me produkte vendas, gatime tradicionale, guida turistike. Kjo Festë përcjell dhe një mesazh të rëndësishëm si "Mbrotjtja e Natyrës".

21
MAJ

FESTA E KOMUNËS LUNIK

TURIZËM

Festa e Komunës Lunik është një nga festat tradicionale lokale që zhvillohet çdo vit në vendin e quajtur Fusha e Letmit në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Nuk mungojnë aktivitetet artistiko-kulturore si dhe gastronomia tradicionale e zonës.

2
GUSHT

FESTA E ÇERMENIKËS

TURIZËM

Zona e Çermenikës ju fton të shijoni mikpritjen e banorëve "të shtëpisë", si edhe bukuritë turistike të zonës me aktivitete kulturore, artistike dhe këngët folklorike të zonës.

15
GUSHT

FESTA E BËRZHITËS

TURIZËM


Ne qytetin e Librazhdit festohet festa e Rrapit të Bërzeshitës. Rrapi është i vjetër rreth 560 vjeçar. Ky fshat e ka traditë këtë festë, ku të gjithë banorët mblidhen dhe festojnë rreth e qark tij.

24
GUSHT

FESTA E MJALTIT

KULTURË

Festa e Mjaltit tashmë është një traditë e përvitshme, ku qëllimi i saj është gjallërimi i jetës turistike. Kjo festë përmbledh një sërë aktivitesh si: panairi tradicional-kulturor, aktivitete kulturore, promovim të turizmit malor, gatime tradicionale (degustime të momentit). Duke promovuar në këtë mënyrë bukuritë natyrore, produkte agro turistike, prodhimet artizanale, si dhe argëtim për pjesëmarrësit.



21
SHTATOR

FESTA E PATATES

TURIZËM

Festa e patates është një aktivitet mjaft i rëndësishëm që zhvillohet për komunitetin vendas dhe jo vetëm, e cila shoqërohet me panair, duke promovuar një prej produkteve bujqësore më të njohura të zonës, "pataten e Stëblevës". Në këtë festë përgatiten në variante të ndryshme gatime të patates.



1
TETOR

KUKËS

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E SHËN GJERGJIT

KULTURË

Shën Gjergji në fshatin Novosej të Kukësit festohet në një mënyrë tepër të veçantë. Kjo festë mbledh pjesëmarrës vendas dhe të huaj për të kremtuar fundin e stinës së dimrit dhe ardhjen e verës. Aktiviteti çelët me panairin e gastronomisë ku banorët vendas u ofrojnë të pranishmëve ushqime të gatuar me shumë mjeshtëri si dhe panairi i artizanatit ku shpaloset një pjesë e trashëgimisë kulturore të Qarkut Kukës. Pjesë e kësaj feste bëhen edhe lojrat popullore si: gara e hedhjes së gurit, kërcimi tre hapsh dhe mundja popullore e pelivanëve, për të cilat jepen dhe çmime.

5-6
MAJ

PELEGRINAZH NË MALIN E SHKËLZENIT

TURIZËM

Ky vend i shenjtë është kthyer prej vitesh në një destinacion të preferuar, ku qindra qytetarë nga Tropoja, Kukësi, Hasi, Puka e Kosova e kanë frekuentuar në ditët e gushtit, duke gjetur paqe dhe besim.

7
GUSHT

FESTA E BOZËS

TURIZËM

Thuhet se të parët që e "shpikën" bozën shqiptare ishin goranët e Kukësit. Sot, ajo prodhohet nga firma dhe familje të ndryshme gati në të gjithë Ballkanin dhe mendohet se përbën një "thesar" ende të pazbuluar mirë. Për një numër familjesh të komunitetit goran në rrethin e Kukësit, kryesisht të fshatrave Borje, Zapod, Shishtavec etj, në historinë e tyre të biznesit, boza zë një vend të veçantë të cilës i kanë kushtuar këtë ditë festive.

26-28
GUSHT

TË QETHMET

TURIZËM

Është një festë tradicionale që ka të bëjë me qethjen e deleve.

5
SHTATOR

TË DUNMET

TURIZËM

Është festë tradicionale që lidhet me kthimin e bagëtive nga kullotat verore në pllajat e maleve në fermat familjare.

20
SHTATOR

DITA E GESHTENJËS DHE E ARRËS

TURIZËM

Kjo është një festë tradicionale e cila zhvillohet në muajin e vjeljes së gështenjes dhe promovon bukurinë natyrore, kulturën dhe traditat.

20
TËTOR

TROPOJË

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITËT E VALBONËS

TURIZËM

Ditët e Valbonës realizohen në kuadër të promovimit të vlerave etnografike, kulturore, lojrave tradicionale dhe gastronomike të zonës. Ky aktivitet do të organizohet në luginën e Valbonës në ambientet e qendrës së zhvillimit të turizmit Valbonë, ku do të këndohen këngë me çifteli, fyell e kaval. Do të realizohen kërcime të ndryshme nga burrat dhe kërcimi i çikave të Tropojës. Do të mbahen lojra tradicionale dhe për keto lojra do të ketë fitues çmimesh simbolike. Pjesë e aktivitetit do jetë edhe panairi i gastronomisë me produktet vendase të zonës.

24-25
MAJ

FESTA E PASTËRMASË

TURIZËM

Kjo festë bëhet në fshatin Lekbibaj, ku promovohen gatimet dhe veshjet tradicionale të zonës.

4

QERSHOR

DITA E GESHTENJËS DHE E ARRËS

TURIZËM

Kjo është një festë tradicionale e cila zhvillohet në muajin e vjeljes së gështenjës dhe promovon bukurinë natyrore, kulturën dhe traditat.

20

TETOR

KOLONJË

KALENDARI I FESTAVE 2019



EU TRANSIT-ALBANIAN FARM

KULTURË

Epiqendra e kësaj Feste Lokale është fshati i Rehovës, i cili është përzgjedhur në projektin e "100 Fshatrave". Potenciali mjedisor-natyror, trashëgimia kulturore dhe potenciali turistik janë ato çka e bëjnë këtë fshat të përshtatshëm për një festë të tillë. Rehova do të presë sipërmarrës evropianë në fushën agro dhe modele suksesi nga gjithë vendi, por edhe të rinj që me sipërmarrjet e veta në këtë fushë, jo vetëm ja kanë dalë, por kanë inspiruar dhjetëra të tjerë në udhën e tyre.

19
MAJ

E BËRË VETË - BIO


TURIZËM

Kjo festë lidhet me ekspozimin e të gjitha Zaireve të zonës. Psh. trahana, rroshnica, petka, reçel, çajra të ndryshëm, narden, punime me grep, raki, muskat, kumbull etj.

25
SHTATOR

VAU I DEJËS

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E LUMIT TË SHALËS

TURIZËM


Dy ditë argëtim mes kanionit gjarpërues me muzikë live nën shoqërinë e miliona yjeve. Lundrim, piknik, kamping, meditim, agriturizëm dhe eksplorime.

19
MAJ



SHIJAK

KALENDARI I FESTAVE 2019



PANAIRI RAJONAL BIOFEST

TURIZËM

Në qytetin e Shijakut zhvillohet aktiviteti 'Biofest', panairi rajonal i prezantimit të pasurisë etnografike, mjeshtërisë artizanale, kulinarisë dhe agrobiznesit të Shijakut, një zonë e rëndësishme me mundësi zhvillimi social dhe ekonomik. Në këtë aktivitet ka një pjesëmarrje të gjerë të bizneseve të ndryshme në ekspozimin e vlerave tradicionale në produktet e ndryshme ushqimore.

25-26
MAJ

PANAIR AGROBIZNES

TURIZËM

Ky panair ka qëllim promovimin e vlerave agrokulturore të zonës.

24-25-26
GUSHT

FESTA E RRUSHIT (Rakia dhe Vera)

TURIZËM

Prodhim tradicional i fshatrave të Shijakut. Festa konsiston në vizitë nëpër kantinat e zonës dhe shtëpitë prodhuese të verës dhe rakisë.

28-29
SHTATOR

LUSHNJE

KALENDARI I FESTAVE 2019



PANAIRI I AGROBIZNESIT TË LUSHNJES

TURIZËM

E kthyer në traditë tashmë çdo prag vere në qytetin e Lushnjes organizohet "Panairi i Agrobiznesit", ku çdo subjekt agrobiznesi në vend që shfaq interes, bëhet pjesë e këtij Panairi.

MAJ



PUKË

KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTË PAGANE ME MIQ

Hani i Përparim Laçit fton të gjithë besimtarët të çelin sezonin turistik veror me gatime tradicionale dhe pritje Pukjane.

KULTURË

28

QERSHOR

FESTA E BIRRËS PUKA

Kjo festë nuk shërben vetëm për të reklamuar një mark, por dhe për të mbledhur banorët dhe vizitorët e tij, duke festuar.

TURIZËM

11

GUSHT

DITA E KULTURËS POPULLORE PUKJANE

Puka është vendi ku punoi Migjeni, vendi i 40 haneve, kishave të vjetra dhe shtëpive muze. Në këtë ditë zhvillohen aktivitete të ndryshme nga të gjitha institucionet e varësisë, si: vizita në monumente, shfaqje artistike, konkurse, ekspozita fotografike dhe artistike, etj.

TURIZËM

10

SHTATOR

SOFRA PUKJANE

Sofra mbledh në qytetin e Pukës të gjithë ata që iu përkasin këtyre rrënjëve apo jetojnë në këtë zonë; përfaqësues politikë, intelektualë, sipërmarrës dhe artistë.

TURIZËM

2

NËNTOR

TURIZMI ME NJERËZIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Gjatë kësaj dite, organizohen lojra popullore, vizita turistike, këngë dhe valle popullore të zonës, dhe drekë tradicionale për persona me aftësi të veçanta, ku ndërkohë promovohen dhe vlerat turistike të zonës.

TURIZËM

3

DHJETOR

LIBOHOVĚ

KALENDARI I FESTAVE 2019



TRADITA LIBOHOVITE

KULTURË

Promovohet në këtë ditë të shënuar kulinaria, agrobiznesi dhe folklori libohovit.




10
GUSHT

TAKIM BREZASH

TURIZËM

Në këtë festë bëhet promovimi i kulinarisë, agrobiznesit dhe folklorit.



17
GUSHT

RROGOZHINË

KALENDARI I FESTAVE 2019



KULINARIA

Kalaja e Bashtovës


TURIZËM

Kalaja e Bashtovës tashmë trashëgimi kulturore e qytetit tonë do të presë turistët me gatimet më të veçanta të zonës, gatuar me mjeshtëri nga banorët e zonës.



13
GUSHT

URA VAJGURORE
KALENDARI I FESTAVE 2019



FESTA E VERËS (Kantina Çobo)

TURIZËM

Kjo festë simbolizon ardhjen e vjeshtës dhe mbledhjen e fryteve të punës së një viti. Festa nis me vjeljen e prodhimit të ri, depozitimin e tij në një enë, ku dhe bëhet shtypja tradicionale. Vijon me derdhjen e verës dhe rakisë. Nisja e vjeljes së prodhimit, shoqërohet me një festë tashmë tradicionale, që zhvillohet nga prodhuesit e verës së zonës.

15
SHTATOR



DEVOLL

KALENDARI I FESTAVE 2019



SOFRA DEVOLLIT

TURIZËM

Sofra e Këngës dhe valles Devollite është mbajtur për herë të parë në 100 vjetorin e Pavarësisë dhe tashmë po kthehet në traditë.

SHTATOR



MALESI E MADHE

KALENDARI I FESTAVE 2019



PANAIR NË REÇ


TURIZËM

Panairi në Reç, është nga panairët më të sukseshme agro turistike të organizuara në vend. Në këtë panair gjenden prodhimet më të spikatura të zonës si reçelrat, mjalti, dhe gështenjat. Në këtë aktivitet ofrohen dhe guida të ndryshme turistike, që mund të zhvillohen në këtë zonë.



TETOR

KALENDARI I FESTAVE 2019



DITA E SHËRBIMIT PYJOR SHQIPTAR

TURIZËM

Është shpall në kujtim të 27 Janarit 1923, ditë ku u miratua “Ligji i parë shqiptar i pyjeve dhe kullotave”, i cili i dha shtysë zhvillimit të qëndrueshëm, duke sjellë një menaxhim më të mirë të pyjeve dhe ruajtjen e ekuilibrave natyrore.

27
JANAR



